



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

## BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 49 4 – 10 Dhjetor 2023

Për këtë periudhë, kanë raportuar 35 NJVKSH ose 97% (=35/36) e tyre

35 NJVKSH ose 97% (=35/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEÇ, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 1 NJVKSH ose 3% (=1/36) e tyre: HAS

### NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 49

	JAVA 49
DIARRE PA GJAK	983
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.076
INF. RESP. TE POSHTËME	3.063
RASH ME TEMPERATURË	45
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	417
% e Njësive Raportuese	94% (417/446)

### **Rash me temperaturë**

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Dibër – 25 raste

Fier - 2 raste

Kurbin – 3 raste


Pogradec – 4 raste

Tirane – 11 raste


---

### Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ritje në javën 49 krahasuar me javën paraardhëse, java 48.

### Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqitet e qëndrueshme në javën 49 krahasuar me javën paraardhëse, java 48.

**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




**Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 - 49 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.**




Në javën 49 të vitit 2023 vërehet prirje në ritje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.

**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 48 dhe 49 / 2023. Incidenca (raste/10.000)**




**Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 40 - 49 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.**



Në javën 49 të vitit 2023 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 48 dhe 49 / 2023.  
Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

## Ngjarje ndërkombëtare

### 1. *Shpërthim epidemik i fruthit – Rumani – 2023*

- Më 5 dhjetor 2023, Ministria e Shëndetësisë e Rumanisë shpalli një epidemi kombëtare të fruthit, duke hapur rrugën për dozën e parë të vaksinës MMR që do t'u jepet fëmijëve nga mosha nëntë muajshe.
- Ky shpërthim paraqet rrezik për eksportim të mundshëm të përsëritur drejt vendeve të tjera të BE/EEA dhe rrjedhimisht transmetim të vazhdueshëm në disa prej tyre, ku mbulimi me vaksinim është nën optimale.
- Përpjekjet për reagim po vazhdojnë në Rumani për të siguruar që xhepat e mëdhenj të individëve të prekshëm të vaksinohen me shpejtësi.

### 2. *Zbulimi i një rasti me linë e majmunit në një anije lundrimi në Azinë Juglindore e grupin e meshkujve që bëjnë seks me meshkuj (MSM)*

- Më 1 dhjetor 2023, Gjermania njoftoi ECDC-në për një rast mpox të zbuluar në Gjermani, i cili kishte marrë pjesë në një anije lundrimi në Azinë Juglindore. Lundrimi u zhvillua midis 11 dhe 21 nëntorit 2023, me rreth 2 300 pasagjerë nga e gjithë bota.
- Rreziku i ekspozimit ndaj pasagjerëve në anijen turistike ka të ngjarë të jetë i lartë duke pasur parasysh se rasti i raportuar ishte simptomatik gjatë lundrimit dhe ai është në dijeni të rasteve të tjera të mundshme.
- ECDC është në kontakt me OBSH/EURO, CDC të SHBA-së dhe partnerë të tjerë përkatës të BE-së për të mbledhur më shumë informacion rreth kësaj ngjarje. ECDC inkurajon vendet të ndajnë informacion në lidhje me këtë ngjarje në artikullin e EpiPulse.

### 3. *Rritje e infeksioneve të frymëmarrjes për shkak të Mycoplasma pneumoniae në BE/EEA gjatë sezonit 2023/2024*

- Që nga java e 48-të, tendencat e zbulimit të Mycoplasma pneumoniae vazhdojnë të rriten në Holandë.
- Rritjet e infeksioneve me M. pneumoniae ndodhin periodikisht, zakonisht çdo një deri në tre vjet. Sëmundja transmetohet nga kontakti i ngushtë me një person të infektuar.
- Rritjet e fundit në zbulimet e vëzhguara mund të pasqyrojnë përsëritjen tipike periodike të M. pneumoniae në komunitet dhe potencialisht përkeqësohet nga një periudhë trevjeçare e transmetimit dhe zbulimit shumë të kufizuar të M. pneumoniae në BE/EEA.
- Megjithëse rastet e infeksionit me M. pneumoniae nuk janë të detyrueshme për njoftim në shumicën e vendeve të BE/EEA, mbetet e rëndësishme të vazhdohet monitorimi i shfaqjes së formave atipike dhe/ose të rënda të sëmundjes, ose evidencave të rezistencës ndaj antibiotikëve.

### 4. *Survejanca sezonale e virusit të Nilit Perëndimor– 2023*

- Që nga përditësimi i fundit dhe që nga 6 dhjetori 2023, asnjë rast njerëzor i infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) nuk është raportuar nga vendet e BE/EEA dhe asnjë rast nuk është raportuar nga asnjë vend fqinj me BE-në.
- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit 2023, 707 raste njerëzore të infeksionit WNV janë raportuar nga vendet e BE/EEA dhe 93 nga vendet fqinje të BE-së.

• Që nga fillimi i sezonit të transmetimit të WNV 2023, dhe që nga 6 dhjetori 2023, vendet e BE/EEA kanë raportuar 152 shpërthime në mesin e ekuidëve dhe 247 shpërthime midis shpendëve.

## Ngjarje kombëtare

### *5. Raste të dyshuara me varicelë, Maqellarë, Dibër*

Në datë 8.12.2023 në dy shkolla 9 vjecare në Njësinë Administrative Maqellarë janë raportuar disa raste të dyshuara me varicelë (afërsisht 20 nxënës). Nxënësit i përkasin klasës së parë dhe janë të gjithë të vaksinuar ndaj fruthit.

Njoftimi është kryer nga mjekja e familjes në shërbimin e epidemiologjisë pranë NJVKSH Dibër që ka kryer hetimin në vatër. është komunikuar me titullaret e shkollave dhe të gjithë rastet janë izoluar në shtëpi.

Janë dhënë udhëzimet përkatëse për cdo nxënës që shfaq shenja klinike të varicelës duhet të shkojë në shtëpi.

Deri tani asnjë rast nuk ka shkuar për të marrë shërbim në spital. Vazhdon komunikimi me mjeken e familjes për monitorimin e situatës dhe deri tani situata është në kontroll.

U rekomandua marrja e mostrave në rastet në vazhdim për të konfirmuar diagnozën nga ana laboratorike.